



PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 25 JANAR 2000.

TREGUESIT MONETARË NË FUND TË VITIT 1999 DHE MASAT E MBIKËQYRJES PËR ECURINË E SISTEMIT BANKAR

Të dhënat operative për ecurinë e depozitave në muajin dhjetor 1999.

Sipas evidencave operative të bankave tregtare, gjatë muajit dhjetor **depozitat në sistem** u rritën me rreth 3.5 miliardë lekë. Peshën kryesore në këtë rritje e kanë **depozitat në valutë** me rreth 2.5 miliardë lekë dhe rreth 1 miliard lekë e përbëjnë **depozitat në lekë**.

Kontributin kryesor në këtë rritje e ka **Banka e Kursimeve** me mbi 60 për qind të rritjes në gjithë sistemin, ndërsa pjesën tjetër **bankat me kapital privat dhe të përbashkët**.

Sipas këtyre të dhënave del se muaji dhjetor është karakterizuar nga rritja me ritme më të larta të depozitave në valutë kundrejt depozitave në lekë në sistem.

Muaji dhjetor reflektoi një situatë financiare të ndryshme nga muajt e mëparshëm përse i përket rritjes së:

- *deficitit buxhetor* me 10.7 miliardë lekë (që nga fundi i muajit nëntor);
- *parasë jashtë bankave* që njohu rritjen më të lartë të vitit me rreth 6.1 miliardë lekë;
- *emisionit të parasë* me rreth 4.0 miliardë lekë.

Pas nje ecurie normale të depozitave në lekë në sistem gjatë dy javëve të para të muajit dhjetor, dy javët e fundit të këtij muaji u karakterizuan edhe nga tërheqje të depozitave me afat.

Ky fenomen u vu re në Bankën e Kursimeve, ndërkohë që në bankat e tjera të sistemit situata ishte e qetë dhe deri në fund të muajit rritja për këto banka, sipas të dhënave operative rezultoi 249.6 milionë lekë.

Ecuria e depozitave me afat në këtë bankë u influencua nga efekti që patën në publik disa artikuj të shkruar në shtypin e ditës lidhur me sigurinë e depozitave në lekë të qytetarëve në Bankën e Kursimeve, në fazën e privatizimit të kësaj banke. Informacionet ditore të raportuara nga kjo bankë kanë treguar se në dy javët e fundit të muajit dhjetor pagesat për depozitat kanë qenë më të larta se sa pranimet e depozitave. Në fund të muajit dhjetor rritja e **depozitave pa afat (llogari rrjedhëse) në lekë** ishte rreth 920 milionë lekë, ndërsa **depozitat me afat** 40 milionë lekë.

Në *strukturën e depozitave sipas afatit* për muajin dhjetor (të vlerësuar operativisht), vërejmë se ka patur një rënie për depozitat tremujore nga 54.18 për qind të totalit të depozitave me afat në nëntor në 54.05 për qind në dhjetor, ndërkohë pjesa që zënë depozitat me afat gjashtëmujor është rritur nga 6.71 për qind në nëntor në 6.82 për qind në dhjetor dhe ato me afat dymbëdhjetëmujor kanë qëndruar pothuajse të pandryshuara, nga 38.64 për qind në nëntor në 38.67 për qind në fund të dhjetorit.

Depozitat në valutë kanë patur një rritje në 2.5 miliardë lekë nga të cilat 1.5 miliardë lekë janë **depozita me afat** dhe 989.7 milionë **llogari rrjedhëse**, ku përsëri kontributin kryesor e ka dhënë Banka e Kursimeve, me rreth 70 për qind të rritjes.

Deri në datën 15 janar 2000 të dhënat (pa informacionet e Bankës së Kursimeve dhe të Bankës së Tiranës që kanë vështirësi në informacion nga aplikimi i sistemeve të reja informatike) të dhënat flasin për *një rritje normale të depozitave në lekë* me rreth 200 milionë lekë (nga të cilat depozitat me afat 195 milionë lekë) dhe për *një rritje të depozitave në valutë* me rreth 163 milionë lekë (depozitat me afat janë rritur 372 milionë lekë).

VLERËSIMET PËR AGREGATËT MONETARË NË FUND TË VITIT 1999

Në fundin e vitit 1999, Banka e Shqipërisë vlerëson një rritje të depozitave gjithsej prej rreth 38,6 miliardë lekësh, ku vetëm depozitat në lekë zënë rreth 55 për qind. Duke krahasuar të dhënat për vitin 1998 dhe për vitin 1999, Banka e Shqipërisë i vlerëson si pozitive zhvillimet në përgjithësi gjatë vitit 1999.

Është theksuar dhe në raste të tjera mosndikimi i krizës kosovare në treguesit e përgjithshëm monetarë. Në mënyrë të përmblodhur, disa të dhëna për agregatët monetarë dhe depozitat jepen në tabelën më poshtë:



Agregatët Monetarë	Viti 1998 (mld lekë)	Viti 1999 (Vlerësim) (mld lekë)	Rritja vjetore (në përqindje)
- M3	239.5	290.9	21.5
- M2	199.3	233.2	17.0
- M1	83.7	98.3	17.4
Paraja jashtë bankave	68.3	81.1	18.7
Depozitat gjithsej	171.2	209.8	22.5
- Depozitat në lekë	130.9	152.1	16.2
- Depozitat në valutë	40.3	57.7	43.4

Për vitin 1999, struktura përbërëse e *parasë gjithsej*, në përgjithësi, ka një përmirësim të raporteve, kryesisht përsa i përket depozitave gjithsej ndaj parasë jashtë bankave, dhe depozitave në valutë ndaj depozitave në lekë. Këto raporte krahasuar me ato të një viti më parë paraqiten si më poshtë:

Ecuria e treguesve të depozitave dhe parasë jashtë bankave

Raporti në përqindje	Dhjetor '98	Dhjetor '99
<i>para jashtë bankave/para gjithsej</i>	28.52	27.9
<i>depozita/para gjithsej</i>	71.48	72.13
<i>depozita në lekë/depozita gjithsej</i>	76.48	72.49
<i>depozita në valutë/depozita në lekë</i>	34.84	37.94

Gjatë vitit 1999, Banka e Shqipërisë, duke u bazuar në zhvillimet në indeksin e çmimeve të konsumit, rezervat valutore dhe kursin e këmbimit të lekut me monedhat kryesore që tregtohen në vend, ecurinë e depozitave në sistemin bankar, objektivat sasiorë të programit afatmesëm të Shqipërisë me FMN-në, ka ulur gjashtë herë nivelin minimal të depozitave me afat në lekë, duke arritur në fund të vitit në nivelin 9 për qind për depozitat me afat maturimi dymbëdhjetëmujor (shih tabelën bashkëngjitur).

Bazuar në nivelin e ulët të indeksit të çmimeve të konsumit në fund të vitit 1999, stabilitetin e kursit të këmbimit, parashikimet për të ardhmen me tendenca të qëndrueshme për përmirësime në disa tregues dhe në nivelin pozitiv të interesave realë, Banka e Shqipërisë në datën 19 janar 2000, uli përsëri nivelin minimal të normave të interesit për depozitat me afat në lekë të bankave publike dhe konkretisht në 8 për qind, 8,25 për qind dhe 8,5 për qind për maturimet tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmujore.

Kursi i këmbimit dhe niveli i rezervave valutore bruto vazhdojnë të jenë relativisht të qëndrueshëm edhe gjatë këtyre ditëve të janarit.

DISA PARASHIKIME PËR VITIN 2000.

Banka e Shqipërisë edhe në vitin 2000 do të vazhdojë të ndjekë një politikë të matur monetare për të ruajtur një nivel të ulët të inflacionit. Nisur nga ecuria e çmimeve të konsumit për vitin 1999 dhe vlerësimi që ka bërë Banka e Shqipërisë (se në përgjithësi presionet inflacioniste në vitin 2000 do të rriten), është gjykuar që objektivi për inflacionin në vitin 2000 të jetë rreth 3 për qind.

Instrumentet monetare që Banka e Shqipërisë do të përdorë në realizimin e programit të saj do të vazhdojnë të jenë rezervat e detyrueshme si dhe caktimi i nivelit minimal të normave të interesit për depozitat në lekë në bankat shtetërore.

Lidhur me normat e interesit, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të përcaktojë kufirin minimal të interesit të depozitave me afat në bankat me kapital tërësisht shtetëror (duke i ruajtur pozitive në terma realë). Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti do të punohet për të kaluar nga përcaktimi i interesave në mënyrë administrative, në atë mbi baza tregu. Për këtë, një rëndësi të madhe ka ecuria në privatizimin e Bankës së Kursimeve.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të punojë në një regjim fleksibël të kursit të këmbimit, duke ndërhyrë në tregun valutor kur do të shohë se ka luhatje spekulative të kursit të këmbimit. Rezerva valutore bruto mendohet të mbahet fare pak nën nivelin e fundit të vitit 1999. Paraja gjithsej është parashikuar të rritet 10 për qind, ndërkohë që raporti i parasë jashtë bankave ndaj parasë gjithsej është parashikuar të ulet në favor të depozitave duke arritur 25,2 për qind. Raporti i depozitave në valutë ndaj parasë gjithsej është parashikuar të qëndrojë pothuajse i pandryshuar (20 për qind).

Kjo rritje e parasë, parashikohet të plotësojë kërkesat e ekonomisë për kredi, me një parashikim në rritjen e portofolit të bankave të nivelit të dytë prej 7,5 miliardë lekësh (në vitin 1999 është vlerësuar një rritje rreth 2 miliardë lekë) dhe të deficitit të financuar me burime të brendshme për 23,6 miliardë lekësh.



MASAT QË JANË MARRË DHE DO TË MERREN PËR FORCIMIN E SISTEMIT BANKAR.

Në mbështetje të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12 dhe të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 41, Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe mbikëqyrjen e të gjitha bankave dhe degëve të bankave të huaja (banka) në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 1999, Banka e Shqipërisë ka nxjerrë akte normative dhe jo normative (rregullore) me synim sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit bankar. Mund të përmendim rregulloret:

- për dhënien e licencave për bankat e nivelit të dytë;
- për administratorët e bankave të nivelit të dytë;
- për subjektet jobankare;
- për këmbimet valutore;
- për kapitalin rregullator etj..

Banka e Shqipërisë, me anë të mbikëqyrjes bankare, siguron përputhje të aktivitetit të bankave dhe degëve të bankave të huaja me ligjet dhe aktet normative në fuqi, mbikëqyrje e cila realizohet nëpërmjet inspektimeve të plota e të pjesshme që kryhen në to. Inspektimet e plota kryhen si rregull një herë në 2 vjet. Për vitin 2000, Banka e Shqipërisë synon që në vartësi të gjendjes së përgjithshme financiare të bankës, të kryejë inspektime një herë në tetëmbëdhjetë ose dymbëdhjetë muaj.

1. Banka e Shqipërisë për vitin 1999, kishte planifikuar të kryeshin inspektime të plota në 4 banka (Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Italo - Shqiptare, Bankën Amerikane të Shqipërisë dhe në Bankën e Kursimeve). U arrit të kryhen **inspektime të plota** edhe në tre banka të tjera.

Nëpërmjet tyre është synuar që të sigurohet prej bankave respektimi i licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë me objektiv kryerjen e veprimtarisë së qëndrueshme financiare dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar.

Për vitin 1999, Mbikëqyrja Bankare është fokusuar në mbulimin dhe mbajtjen nën kontroll të veprimtarive kryesore të sistemit bankar si: menaxhimi dhe administrimi; aktiviteti kreditues; likuiditeti; kontrollet e

brendshme etj..

2. Për **inspektime të pjesshme** lidhur me veprimtarinë kredituese në dy banka të planifikuara për këtë vit, u realizuan tre.

Janë kryer inspektime të pjesshme edhe për:

- pozicionet e hapura valutore në monedhë të huaj;
- funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm;
- zbatimin e rregulloreve “Për tregun e këmbimeve valutore” dhe “Parandalimin e pastrimit të parave”.
- Për herë të parë janë inspektuar të gjitha zyrat e këmbimit valutor, nga 8 të programuara.

Banka e Shqipërisë për vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes financiare të bankës, përdor sistemin “**CAMELS**”, që u aplikua për herë të parë gjatë vitit të kaluar, dhe përfshin ekzaminimin e të gjitha elementeve, që sigurojnë një aktivitet bankar të shëndoshë dhe të sigurtë.

Gjatë inspektimeve të vitit 1999, ka rezultuar se gjendja e sistemit bankar në përgjithësi është e mirë. Bankat kanë politika dhe procedura të mjaftueshme për të identifikuar, matur, kontrolluar dhe monitoruar rreziqet.

Për gjetjet kryesore të ekzaminimeve, Banka e Shqipërisë ka marrë masa korrektuese për përmirësimin e gjendjes. Problemet e rezultuara në bankat me kapital shtetëror (Banka e Kursimeve Sh.a dhe Banka Kombëtare Tregtare Sh.a) i janë bërë prezente aksionerit të vetëm, Ministrisë së Financave.